



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 400/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Valon Ramadani nga subjekti politik Nisma për Kosovën, dega në Ferizaj, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me dt. 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

- I. Miratohet** si e bazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Valon Ramadani nga radhët subjektit NISMA për Kosovën, dega në Ferizaj.
- II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ti rinumëroi vetëm fletëvotimet për kandidatët e subjektit NISMA për Kosovën në Vendvotimin (VV) 2605D/03R.
- III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit të VV të lartpërmendur të përfshihet në rezultatit përfundimtar.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga kandidati për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Nisma dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se gjatë plotësimit të FRK-së nga ana e kryesuesit të VV 2605D/03R, nuk i janë proceduar gjithsej 6 vota.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmitë ka ofruar deklaratën e komisionerit të VV 2605D/03R, Shpëtim Bugujevci.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “*Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme*”

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:

- **ankesa është e bazuar**

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati Valon Ramadani nga subjekti politik Nisma, dhe në këtë drejtim në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të fletëvotimeve për të cilat kandidati në fjalë pretendon në ankesën e tij se është dëmtuar nga mos procedimi i 6 votave në FRK nga ana e Kryesuesit të VV 2605D/03R.

Nga ekipi hetues i PZAP-it është konstatuar se kutia e votimit me nr. 2605D/03R për Komunën e Vitisë ishte e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shiriti në mes të kutisë. Shiritat anësor të kutisë kanë nr. 114308, 114306, 114309 dhe 114307 ndërsa shiriti i mesëm nr. 092905 i cili nuk ishte i prekur fare. Shiriti brenda kutisë votimit kishte nr.114305 poashtu e njëjta kuti e votimit pas përfundimit të hetimit, ekipi hetues konstaton se thesi brenda kutisë ishte mbyllur me shiritin e sigurisë me nr. 087046 dhe mbyllja e kutisë me shiritat të sigurisë si 087045, 087062, 087061 dhe 0010390.

PZAP-i, ka konstatuar nga origjinali i FRK-së që gjendet në QNR, se kandidati me nr. 55 nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën nuk posedon asnjë votë, ndërsa pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutinë e votimit 2605D/03R del se janë 7 fletëvotime të vlefshme të kandidatit në fjalë.

Nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, 117.4 dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 400/2014 më datën 30.06.2014



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*